



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM
Nr. 256, datë 17.06.2021

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...}, PËR VITIN 2019

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukpëraj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

RAPORT
VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL I GJYQTARIT
{...}
VITI 2019

Ekstrakt

POLI I DREJTËSISË
RRUGA “ANA KOMNENA”
TIRANË

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1. A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi pa qenë e lidhur me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale, pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, nga e cila do të përcaktohet më pas natyra juridike e saj, e për pasojë edhe referenca relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- *Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:*

Gjyqtari përshkuan faktet dhe rrethanat e çështjes, duke integruar në to të dhënat e marra nga provat në gjykimin në shkallë të parë. Në rastet kur shkaqet e ankimit nuk i referohen

përcaktimit të gabuar të rrethanave të faktit, për përcaktimin e këtij të fundit, gjyqtari nuk ripërsërit dhe as liston provat e marra në gjykimin në shkallë të parë. Ai i përmbahet dhe evidenton faktet e provuara në gjykimin në shkallë të parë. Nga vendimet burim vlerësimi nuk konstatohet që të jetë ndonjë çështje e gjykuar si juridiksion fillestar apo që të jetë përsëritur hetimi gjyqësor në shkallë të dytë, për të parë një qasje të ndryshme të pasqyrimin të faktit nga ai i shkallës së parë.

Duke u nisur nga mënyra se si pasqyrohen rrethanat e çështjes në 8 dokumentet ligjore, vlen të theksohet se në të gjitha vendimet pavarësisht natyrës së gjykimit (*gjykim civil, apo kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake*) “faktet e çështjes”, parashtrohen në pjesën e parë të pjesës përshkruese - arsyetuese të vendimit dhe po kështu rezultojnë si nën pjesë e titulluar e vendimit gjyqësor.

Gjyqtari i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik dhe që nuk i referohet vetëm asaj çfarë kanë prezantuar palët në pretendimet apo prapësimet e tyre, por në përputhje dhe i integruar me provat e administruara gjatë gjykimit. Kjo vëmendje për të pasqyruar saktë rrethanat e çështjes, me qëllim nxjerrjen më pas të faktit juridik civil dhe cilësimit juridik të tij, konstatohet në mënyrë të veçantë në ato vendime gjyqësore në të cilat gjyqtari ka vlerësuar ndryshe nga vendimi i shkallës së parë¹. Në rastet kur në apel shqyrtohet një vendim jo përfundimtar siç është rasti i kthimit të akteve, gjyqtari edhe pse nuk pasqyron faktin juridik civil, përshkruan me hollësi të gjitha rrethanat mbi ecurinë procedurale të çështjes.²

Në çdo dokument ligjor evidentohet kujdesi i duhur që gjyqtari tregon, për cilësim të saktë të ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike, pavarësisht nëse përcaktimi i gabuar ose jo i faktit, ka përbërë ose jo shkak ankimi.

- Identifikimi i natyrës së çështjes

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjyqtari konkludon në vendim për natyrën e marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, administrative apo kërkesë penale, si dhe institutin përkatës juridik (*marrëdhënie pune, titull ekzekutiv, padi pronësie, etj*). Nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtari dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që edhe në rastet kur përcaktimi i natyrës së çështjes nuk bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, ajo kuptohet qartësisht nga analiza e secilit element të kërkuar nga ligji.

- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në moscitimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi.

¹Vendimi nr.483 datë vendimi 20.05.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë

²Vendimi nr.62 datë vendimi 28.01.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (i) vendime civile dhe (ii) kërkesë penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e pretendimeve për shkelje procedurale, konstatohet se:

(i) Në vendimet civile (mosmarrëveshje pronësie, pune, pavlefshmëri veprimi juridik apo pavlefshmëri titulli ekzekutiv), gjyqtari identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil, por edhe ligjeve organike përkatëse. Konkretisht në disa prej vendimeve burim vlerësimi evidentohet citimi dhe analiza e dispozitave materiale civile lidhur me:

- a) *Pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik*, duke cituar për këtë qëllim nenin 92/a të K.Civil.³
- b) *Zgjidhjen e kontratës së punës*, duke cituar nenin 141 të K.Punës për të përcaktuar mënyrën e përfundimit të kontratës së punës me afat të pacaktuar, nenin 143 të K.Punës në lidhje me respektimin e afatit të njoftimit për përfundimin e marrëdhënies së punës si dhe nenin 153 të K.Punës në kuadër të zgjidhjes së çështjes nëse në rastin objekt gjykimi jemi para një zgjidhje të bërë nga ana e punëdhënësit në mënyrë të menjëhershme dhe të justifikuar si dhe pasoja ligjore e kësaj zgjidhje e parashikuar në nenin 155 të K.Punës⁴.
- c) *Titujt ekzekutiv*, duke identifikuar dhe cituar ligjin e posaçëm, nenin 1 të ligjit nr. 8662 datë 18.09.2000 "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturave të konsumit të energjisë elektrike", dhe nenin 609 të K.Pr.Civile në funksion të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm si dhe të drejtës së paditësit debitor për të kërkuar pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv⁵.
- d) *Dorëzanimë*, si një institut për përmbushjen e detyrimeve, duke cituar për këtë qëllim nenin 600 të K.Civil në funksion të përcaktimit të shuarjes apo jo të dorëzansisë, referuar kërkimit dhe shkakut ligjor të padisë së evokuar nga paditësi⁶.

Në vendimet gjyqësore evidentohet citimi dhe analiza e dispozitave procedurale civile lidhur me:

- a) *Instituti e gjësë së gjykuar* kur kjo çështje është bërë objekt i ankimit dhe shqyrtimit gjyqësor në apel, dispozitë procedurale kjo relevante në lidhje me zgjidhjen e çështjes në themel (nenin 451/a të K.Pr.Civile)⁷.
- b) *Paditë që nuk mund të ngrihen*, ku në dy vendime gjyqësore të të njëjtës natyrë juridike, citon nenin 468 të K.Pr.Civile në fuqi në momentin e paraqitjes së ankimit për zgjidhjen përfundimtare të çështjes objekt gjykimi për pushimin e gjykimit të çështjes si padi që nuk mund të ngrihen⁸.

³Vendimi nr. 638 datë vendimi 01.07.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë

⁴Vendimi nr. 904 datë vendimi 11.11.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë

⁵Vendimi nr. 899, datë vendimi 11.11.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë

⁶ Vendimi nr.483 datë vendimi 20.05.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë

⁷Vendimi nr. 638 datë vendimi 01.07.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë

⁸Vendimi nr. 733 datë 16.09.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë, dhe vendimi nr. 210 datë 25.02.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë

- c) *Kthimin e akteve* (neni 154/a të K.Pr.Civile) si dhe dispozitën procedurale të gjyqimit të çështjes në apel në lidhje me disponimin e gjykatës së apelit në funksion të zgjidhjes së çështjes.⁹
- d) *Titujt ekzekutiv dhe pavlefshmërisë së tyre*, duke identifikuar për këtë qëllim nenin 510 (d) të K.Pr.Civile për të përcaktuar se kontratat e kredisë bankarë janë tituj ekzekutiv *ipso lege* dhe për këtë qëllim nuk është e nevojshme ngritja e padive me palë kundërshtarë, apo zbatimi i dispozitës procedurale civile (*nenin 609 të K.Pr.Civile*) që ka lidhje me marrëdhënien juridike të krijuar ndërmjet palëve me qëllim konstatimin e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv objekt kërkimi.¹⁰

(ii) Në vendimin e vetëm penal (kërkesë penale - caktim mase sigurimi), gjyqtari identifikon dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet masës shtrënguese më të përshtatshme që duhet të vendoset ndaj personit nën hetim, e duke cituar për këtë qëllim *nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale* në lidhje me kushtet (*e përgjithshme dhe të veçanta*) dhe kriteret e caktimit të masave të sigurimit¹¹.

- Konflikti i normave materiale apo procedurale

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret. Nga ana tjetër nuk konstatohet asnjë rast ku analiza e konfliktit të normave të ketë qenë e domosdoshme.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t'i japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Pavarësisht faktit që interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i çdo gjyqtari, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt

⁹ Vendimi nr.62 datë vendimi 28.01.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë

¹⁰ Vendimi nr.483 datë vendimi 20.05.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë

¹¹Vendimi nr. 560 datë vendimi 24.07.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë

normës ligjore, në mënyrë të veçantë gjykatat më të larta (Apelit apo Gjykata e Lartë) duhet të luajnë një rol të rëndësishëm për t'i udhëzuar gjykatat më të ulëta në interpretimin, sqarimin dhe zbatimin e së drejtës materiale dhe procedurale.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Në 8 vendimet objekt vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale - civile apo procedurale penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Në çdo rast, citimi i dispozitave integrohet me një fakt të caktuar apo me konkluzionin e arritur në shërbim të së cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarit sipas mënyrës së interpretimit të tyre në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në këtë kontekst, konstatohet se gjyqtari kryesisht përdor interpretimin teleologjik të normës konkrete (*ratio legis - për të cilën ajo është krijuar*) dhe, duke e përputhur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, arrin në konkluzionin në lidhje me shkaqet e ankimit¹². Konstatohet edhe interpretimi i normës juridike në këndvështrimin historik (*ndryshimet e ligjeve për kthimin dhe kompensimin e pronave*) dhe krahasues të tyre, gjithmonë në funksion të përcaktimit të qëllimit të ligjit të zbatueshëm.

Referuar rolit të rëndësishëm që duhet të luajnë gjykatat e apelit për zhvillimin dhe formimin e jurisprudencës, evidentohet se gjyqtari qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë¹³ apo indirekt¹⁴ udhëzon në çdo rast gjykatat më të ulëta në interpretimin dhe zbatimin sa më të drejtë të së drejtës materiale dhe procedurale.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:

Interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet te plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por ai lidhet gjithmonë me faktet e provuara. Interpretimi i normës bëhet gjithmonë në funksion të natyrës së marrëdhënies juridike e shkaqeve të ngritura në ankim nga pala. Konkretisht, në mënyrë më specifike në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi, evidentohet se:

- a) Gjyqtari interpreton nenin 153 të K.Punës nëse përmbushen në mënyrë kumulative kriteret ligjore për të zgjidhur kontratën e punës në mënyrë të menjëhershme në rastin konkret. Këtë interpretim gjykata e bën jo vetëm duke iu referuar interpretimit teorik të dispozitës, por në përputhje edhe me faktin dhe provat e administruara. Po kështu interpreton në përputhje me faktet dhe provat, nenin 144 të K.Punës për të përcaktuar nëse në rastin

¹² Vendimi nr.62 datë vendimi 28.01.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

¹³ Shih për më tepër vendimin nr. 62 datë 28.01.2019 I Gjykatës së Apelit Tiranë, ka evidentuar gabimet procedurale të bëra nga gjykata e shkallës së parë në interpretimin dhe zbatimin e normës procedurale të kthimit të akteve si dhe duke orientuar shkallën e parë në kryerjen e veprimeve procedurale të parashikuara në K.Pr.Civile, në mënyrë që të respektohet procesi i rregullt ligjor.

¹⁴ Shih për më tepër vendimin nr. 483 date 20.05.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë, ku gjyqtari evidenton interpretimin e gabuar të nenit 600 të K.Civil nga ana e gjyqtarit të shkallës së parë.

objekt gjykimi është respektuar procedura e zgjidhjes së kontratës së punës nga ana e punëdhënësit.¹⁵

- b) Interpreton nenin 600 të K.Civil, duke e identifikuar dhe interpretuar normën ndryshe nga vendimi i shkallës së parë si një normë me karakter të përgjithshëm që zbatohet edhe në rastin e të gjitha detyrimeve të siguruara me dorëzani, në funksion të përcaktimit të shuarjes së dorëzansisë, referuar kërimit dhe shkakut ligjor të padisë.
- c) Interpreton në përputhje me faktin dhe provat dy dispozitat materiale dhe procedurale të cilat kanë lidhje me njëra - tjetrën (*nenin 609 të K.Pr.Civile dhe nenin 600 të K.Civil*) me qëllim konstatimin e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv kredi bankare për dorëzansin për shkak të shuarjes së dorëzansisë, për sa kohë kreditori nuk ka kërkuar brenda 6 muajve nga mbarimi i afatit të kontratës së kredisë ekzekutimin e detyrimit ndaj dorëzansit.¹⁶

Përpos dispozitave të Kodit Civil dhe atij Penal, gjykata interpreton edhe ligjet e posaçme relevante të zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes civile të evidentuara në raportin analitik për çdo vendim gjyqësor¹⁷.

- Për sa i përket interpretimit të dispozitave procedurale

Gjykata referuar pretendimeve të ngritura nga ana e palëve në ankim, interpreton në përputhje me rrethanat e faktit, dispozitat procedurale që kanë lidhje jo vetëm me zgjidhjen e mosmarrëveshjes në mënyrë përfundimtare, por edhe për t'i dhënë zgjidhje çështjeve procedurale të ngritura gjatë gjykimit. Konkretisht:

- a) Gjyqtari interpreton në përputhje me faktin dhe ligjin (*nenin 451/a të K.Pr.Civile*), institutin e gjësë së gjykuar në mënyrë të detajuar e duke vlerësuar se në rastin konkret pretendimet e palës paditëse kanë rënë në dekadencë, jo vetëm për shkak të faktit se nuk janë parashtruar as në formën e prapësimit në gjykimin e mëparshëm, por edhe për shkak të faktit se këto pretendime për pavlefshmëri absolute të veprimit juridik në këtë gjykim kanë marrë formën e “gjësë së gjykuar së nënkuptuar” për sa kohë (pasoja e kësaj pavlefshmërie të pretenduar) janë zgjidhur me vendim të formës së prerë në një gjykim tjetër civil.¹⁸
- b) Në vendimin nr. 62 datë 28.01.2019 ka evidentuar gabimet procedurale të bëra nga gjykata e shkallës së parë në interpretimin dhe zbatimin e normës procedurale të kthimit të akteve. Duke e interpretuar sipas metodës teleologjike nenin 154/a të K.Pr.Civile, dhe duke e ndarë atë në dy grup – raste kur padia paraqitet me të meta, gjyqtari analizon se në cilin nën grup përfshihet çështja objekt ankimi, me pasojë prishjen e saj e kthimin për rigjykim¹⁹.

- Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante.

Në shumicën e vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese apo edhe vendimet e Kolegjeve të Gjykatës së Lartë*) në mbështetje të

¹⁵Vendimi nr. 904 datë vendimi 11.11.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë

¹⁶Vendimi nr. 483 datë vendimi 20.05.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë

¹⁷ Vendimi nr. 733 datë 16.09.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë, dhe vendimi nr. 210 datë 25.02.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

¹⁸Vendimi nr. 638 datë vendimi 01.07.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë

¹⁹Vendimi nr.62 datë vendimi 28.01.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë

argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij, posaçërisht në rastet që lidhen me:

- a) Zgjidhjen e kontratës së punës dhe pasojat juridike që rrjedhin prej saj; Konstatohet se nga ana e gjyqtarit është cituar dhe zbatuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjes vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr.19/2007.²⁰
- b) Institutin e pavlefshmërisë së veprimeve juridike; Analiza ligjore mbështetet në konkluzionet e vendimit unifikues nr. 13 datë 09.03.2006 dhe vendimit unifikues nr. 5 datë 30.12.2012 në lidhje me efektet, pasojat apo mënyrën e kontestimit të pavlefshmërisë.
- c) Institutin e “gjësë së gjykuar”; Në arritjen e konkluzionit se pretendimi i palës paditëse ka rënë në dekadencë për shkak të gjësë së gjykuar, mbështetet edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë (vendimit nr. 483 datë 25.09.2014) dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese (vendimet 24 datë 12.11.2008 dhe nr. 36/2013).²¹
- d) Interesin legjitim për të ngritur padi. Konkretisht në rastin e moslegjitimit të abonentit debitor që të kërkojë kthimin e shumës së paguar tepër ndaj OSHEE sha, pa kërkuar pavlefshmërinë e faturave të energjisë elektrike, nga të cilat buron ky detyrim, citohet për këtë qëllim vendimi unifikues nr. 5/2012 i Gjykatës së Lartë në lidhje me interesin për të ngritur padi.²² Këtë vendim unifikues gjyqtari e mban në konsideratë dhe e citon edhe në dy dokumentat e tjera ligjore burim vlerësimi, për të theksuar rëndësinë e këtij elementi procedural në ngritjen e padisë (interesi i ligjshëm) në ato raste kur konstaton mungesë të këtij interesi e për pasojë arsyeton se padia nuk mund të ngrihej.²³

Në dokumentet ligjorë konstatohet gjithashtu identifikimi i Konventave Ndërkombëtare (kryesisht KEDNJ-së dhe nenit 6 të saj) për të ardhur në ndihmë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në lidhje me procesin e rregullt ligjor.

- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës

Gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes gjyqtari përmend dhe zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur, siç janë parimet e procesit të rregullt ligjor apo ai i aksesit të palëve. Gjithashtu konstatohet zbatimi i parimit të proporcionalitetit gjatë arsytimit dhe konkluzionit të arritur në lidhje me caktimin e masës së sigurimit ndaj personit nën hetim.²⁴ Identifikohet dhe reflektohet përmbushja e parimit të kontradiktoritetit e barazisë së palëve, si një nga parimet kryesore të procesit të rregullt ligjor etj.

KONKLUZIONE:

²⁰Vendimi nr. 904 datë vendimi 11.11.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

²¹Vendimi nr. 638 datë vendimi 01.07.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë

²² Vendimi nr. 899 , datë vendimi 11.11.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë

²³Vendimi nr. 733 datë 16.09.2019 të Gjykatës së Apelit Tiranë, dhe vendimi nr. 210 datë 25.02.2019 të Gjykatës së Apelit Tiranë

²⁴Vendimi nr. 560 datë 24.07.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të zakonshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Gjyqtari, përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruese. Përdor të gjitha shkronjat e alfabetit shqip (gjithmonë konstatohet përdorimi i shkronjës “ç” dhe “ë”). Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjet e posaçme të përdorura në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Në përdorimin e instituteve, parimeve, apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim civil dhe penal, nuk rezulton përdorimi i termave latine²⁵, por parimet apo institutet përdoren në gjuhën shqipe.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit të cilin përdoren. Vendimi përgjithësisht është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf në paragrafin tjetër dhe në disa raste, edhe duke e numërtuar.

²⁵Është e diskutueshme nëse përdorimi i fjalëve në latinisht e rrisin apo jo vlerën e një vendimi gjyqësor, duke qënë se konsiderohet si “gjuhë e vdekur”, ndërkohë që vetë jurisprudenca ndërkombëtare kryesisht ajo e GJEDNJ-së shumë terma juridikë i përdor në gjuhën e vjetër latine. Pavarësisht këtij diskutimi, nëse do të konsiderohej vlerë, ajo do të duhej gjithmonë të shoqërohej me kuptimin e saj në gjuhën shqipe me qëllim që ky parim apo institut të bëhej i kuptueshëm edhe nga mosnjohësit e ligjit.

Vlen të evidentohet në rastin e gjyqtarit {...}, përmbledhja e shkaqeve të ankimit mbi të cilat vihet në lëvizje Gjykata e Apelit, pa përsëritje të tyre, çka orjenton palët dhe lexuesin për atë çka do të gjejë zgjidhje në vijim të arsytimit.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër. Pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Çështje, Ligj, Argumentim, Konkluzion*) apo CRAC (*Konkluzion, Ligj, Argumentim, Konkluzion*) etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Gjyqtari ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtari i përmbahet, jo vetëm prezantimit të fakteve dhe identifikimit të ligjit të zbatueshëm por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjyqtari ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese - arsytuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, disponimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, si dhe kërkimet/shkaqet e ankimit të subjekteve në proces.

Pjesa përshkuese arsyetuese është e ndarë në disa nën pjesë në të cilën: (i) gjyqtari fillimisht ndalet në dhënien e një konkluzioni të përgjithshëm në lidhje me qëndrimin ndaj vendimit të shkallës së parë objekt ankimi duke u ndalur shkurtimisht tek respektimi i dispozitave procedurale në funksion të procesit të rregullt ligjor e në vijim në lidhje me respektimin e ligjit material, përcaktimin saktë të natyrës së marrëdhënies juridike, etj; (ii) faktet e çështjes siç rezultojnë nga provat objekt shqyrtimi ku konstatohet se i kushtohet një rol mjaft i rëndësishëm nxjerrjes së faktit të integruar me provat e administruara; (iii) ligji i zbatueshëm, ku citohen në funksion të zgjidhjes së çështjes dispozitat ligjore materiale por edhe ato procedurale si dhe vendimet unifkuese në rastet kur ato gjejnë zbatim; (iv) vlerësimi i gjykatës së apelit në të cilën merret në analizë ligji i zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarit dhe konkluzionin e tij.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës konform nenit 466 të K.Pr.Civile, si dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet se në pjesën e dispozitivit gjithmonë evidentohet e drejta për ushtrimin e rekursit, çka e bën dispozitivin e kuptueshëm edhe për mosnjohësit e ligjit. Në rastet kur gjykata e apelit ka disponuar ndryshe nga shkalla e parë, gjen pasqyrim fakti nëse ky vendim përbën titull ekzekutiv konform nenit 466/1 të K.Pr.Civile (*psh në vendimin nr. 483 datë 20.05.2019 të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, vendimet civile elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile dhe nenit 466 të K.Pr.Civile dhe vendimi me objekt caktim mase sigurimi penale elementët e parashikuar në nenin 245 dhe 249 të K.Pr.Penale. Po kështu vendimet janë të strukturuar në paragrafë me qëllim që palët të kuptojnë konkluzionin dhe arsyetimin e gjykatës për çdo pretendim të ngritur në ankim, në funksion të vendimmarrjes përfundimtare.

Gjyqtari ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, ku gjyqtari identifikon faktet, provat, argumentimin ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm, dhe konkluzionin e arritur.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor. Gjyqtari përdor një metodë të caktuar në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual ashtu edhe në përmbajtje të tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme²⁶. Ndonëse nuk kërkohet shprehimisht në nenin 6 të KEDNJ-së, e drejta e një vendimi të arsyetuar bën pjesë në të drejtën e një gjykimi të drejtë siç garantohet nga neni 6, pika 1 i KEDNJ-së, dhe gjen zbatim si në çështjet civile ashtu dhe ato penale. GjEDNJ-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohej një liri e konsiderueshme veprimi përsa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t'u ankuar.²⁷ Arsyetimi i vendimit duhet të tregojë zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar.

Gjithashtu, ndonëse nuk është gjithmonë e nevojshme që arsyet e dhëna në gjykimin në Apel të jenë aq të plota²⁸, nocioni i zhvillimit të një gjykimi të drejtë kërkon që gjyqtari në Apel duhet të trajtojë në fakt të gjitha çështjet thelbësore që i janë paraqitur në ankim dhe jo thjesht të konfirmojë gjetjet e dhëna në vendimin objekt ankimi nga gjykata më e ulët.²⁹

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Në të gjitha aktet e analizuar rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material civil apo procedural penal. Gjyqtari në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi duke orientuar dhe analizën e koncepteve ligjore (si psh: *nëse kontrata e punës së paditësit ka qenë me apo pa afat, nëse mënyra e përfundimit të marrëdhënies së punës ka qenë normale apo e jashtëzakonshme, nëse zgjidhja është kontratës është e justifikuar, detyrimet e siguruara me dorëzani dhe afatet e kërimit të saj, fuqinë ligjore të titujve ekzekutiv, etj...*) në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Gjyqtari i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme psh:

- *Instituti të pavlefshmërisë së veprimeve juridike*, pasojat që rrjedhin prej saj apo mënyrën e kundërshtimit të tyre,
- *Instituti të gjësë së gjykuar*, analizë të cilën e bën jo vetëm në këndvështrimin teorik, por duke iu referuar për këtë qëllim edhe jurisprudencës relevante në lidhje me këtë institut e

²⁶ Neni 142 i Kushtetutës së RSH-së.

²⁷ Vendimi i GjEDNJ, Çështja "Suominen kundër Finlandës", 24 korrik 2003, paragrafët 34-38 si dhe çështja Hadjanastassiou vs Greqisë, dt. 16.12.1992, fq. 33

²⁸ Vendim i GjEDNJ-së, Çështja "X kundër RFGj", 31 mars 1992,

²⁹ Vendim i GjEDNJ-së, Çështja « Albina vs Rumanisë », 28 Prill 2005 dhe Çështja « Helle vs Finlandes », 19 Dhjetor 1997.

duke u nisur nga këto përcaktime të konkludojë në përputhje me faktin konkret se jemi para ekzistencës së gjësë së gjykuar. Gjyqtari ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi duke orientuar dhe analizën e koncepteve ligjore (pavlefshmërisë së veprimeve juridike dhe gjësë së gjykuar) në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes³⁰;

- *Instituti të pushimit individual nga puna* në mënyrë të jashtëzakonshme duke e konsideruar si një formë e përfundimit të marrëdhënies së punësimit që kryhet nga ana e punëdhënësit në mënyrë të njëanshme dhe për shkaqe të punëmarrësit, qëllimit të këtij instituti në funksion të dhënies së argumenteve ligjore nëse ky qëllim është përmbushur në rastin objekt gjykimi³¹.

Në arsyetimin e vendimeve, në analizën e përdorur nga ana e gjyqtarit për arritjen e konkluzionit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile i kushtohet rëndësi e veçantë, marrëdhënies shkak – pasojë.

Gjyqtari në përgjithësi trajton çështjet thelbësore që i janë paraqitur në ankim dhe këtë e bën jo thjesht duke konfirmuar gjetjet e dhëna në vendimin objekt ankimi nga gjykata më e ulët në rastet kur vendimi i shkallës së parë është gjetur i drejtë³², por duke argumentuar arsyet e lënies së vendimit në fuqi. Gjithashtu konstatohet se në rastet kur vendimarrja e gjykatës së Apelit konsiston në prishjen dhe pushimin e çështjes, prishjen dhe kthimin e çështjes për rigjykim ose ndryshimin e vendimit, gjyqtari jep arsye të shëndosha dhe të qarta për këtë konkluzion³³, duke shpjeguar qartësisht se çfarë faktorësh e shtynë të bënin një vlerësim të fakteve dhe ligjit (material dhe atij procedural) ndryshe nga ai i bërë prej gjykatave më të ulëta³⁴ si dhe arsyet për mospranimin e pretendimeve/argumenteve të palëve ndërgjyqëse.

Referuar dokumenteve ligjorë burim vlerësimi, vlerësohet se arsyetimi i vendimeve është i plotë dhe gjithëpërfshirës ku konstatohet se gjyqtari analizon në detaje bazat dhe arsyetimin e vendimit të ankimuar, kërkesat dhe argumentet e paraqitura nga ankuesi, si dhe jep një interpretim të ligjit duke vlerësuar provat në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes dhe konkluzionit të arritur.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim-konkluzion. Në secilin prej tyre mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit mbështetur në qëndrimet e praktikës gjyqësore. Arsyetimi i vendimeve

³⁰Vendimi nr. 638 datë vendimi 01.07.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë

³¹Vendimi nr. 904 datë vendimi 11.11.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë

³² Vendimi nr. 638 datë vendimi 01.07.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimi nr. 904 date 11.11.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

³³ Vendimi nr. 733 datë 16.09.2019, vendimi nr. 210 datë 25.02.2019, vendimi nr.62 datë 28.01.2019 të Gjykatës, dhe vendimi nr.483 datë 20.05.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

³⁴ Vendimi nr. 560 datë 24.07.2019 Gjykatës së Apelit Tiranë, Vendimi nr. 733 datë 16.09.2019, vendimi nr. 210 datë 25.02.2019, vendimi nr.62 datë 28.01.2019 të Gjykatës, dhe vendimi nr.483 datë 20.05.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë

është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse që përbëjnë shkaqe ankimi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit , të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se çështjet në përgjithësi kanë përfunduar brenda afateve ligjore të parashikuara në K.Pr.Civile. Nga 143 (njëqind e dyzet e tre) çështje gjithsej që kanë të parashikuar afat ligjor për përfundimin e tyre, rezulton se kanë përfunduar tej afatit:

(i) 9 (nëntë) çështje tek kategoria e çështjeve “civile të përgjithshme me palë kundërshtare” me objekt pavlefshmëri e titullit ekzekutiv, të cilat kanë përfunduar jashtë afatit ligjor (60 ditë) të parashikuar në nenin 609 pg fundit i K.Pr.Civile.

- Çështja me nr. 30 rendor tek kategoria e çështjeve “civile të përgjithshme me palë kundërshtare” me objekt pavlefshmëri e titullit ekzekutiv nuk duhet të konsiderohet si çështje me afat ligjor, për përfundimin e saj për shkak se : Çështja në fjalë mban si datë regjistrimi datën 21.01.2017. Afati ligjor 60 ditë është parashikuar për herë të parë me ndryshimet që i janë bërë Kodit të Procedurës Civile me ligjin nr. 114/2016, ligj ky i cili është miratuar në datë 03.11.2016 dhe ka hyrë në fuqi në datë 30.11.2016, pra 15 ditë pasi është botuar në fletoren zyrtare nr. 219 datë 15.11.2016. Në lidhje me këtë çështje, pavarësisht faktit që në kohën e regjistrimit të saj në Gjykatën e Apelit (Janar 2017), ky ligj kishte hyrë në fuqi, dhe pavarësisht rregullit të ligjit procedural në kohën e gjykimit, afati 60 ditë për përfundimin e tyre nuk duhet të llogaritet si afat

për gjykimin e çështjes në Apel, por duhet të konsiderohet si çështje me afat standard minimal kohor, pasi ligji i ri nr. 114/2016 që ka sjellë këtë ndryshim, nuk ka qene në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesëpadive përkatëse pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, e për pasojë nuk duhet të jetë as ligji procedural në gjykimin në Apel. Ky interpretim është edhe nën frymën e legjislatorit të parashikuar në nenin 109 të ligjit 38/2017, pavarësisht faktit që vetë ligji nr. 114/2016 nuk parashikonte ndonjë dispozitë kalimtare në lidhje me zbatueshmërinë e tyre.

- Po kështu çështjet me numër rendor : 5 ; 37 ; 76 ; nuk mund të konsiderohen çështje të gjykuara tej afatit, duke qenë se ai rezulton i kaluar vetëm me 2/ditë, çka nuk zë peshë për volumin e madh të çështjeve të gjykuara nga gjyqtari si relator ;

Sa më sipër për efekt të kësaj kategorie do të konsiderohen të shqyrtuara tej afatit vetëm 5 çështje. Koha e gjykimit të tyre varion nga 68 deri në 175 ditë, me një mesatare vonese prej 44 ditë nga afati 60/ditor i parashikuar në K.Pr.Civile.

(ii) 23 (njëzet e tre) çështje tek kategoria e çështjeve “civile të përgjithshme pa palë kundërshtare” me objekt kundërshtim veprimesh përmbarimore të cilat kanë përfunduar tej afatit ligjor (30 ditë) ose (45 ditë) nga data e regjistrimit të çështjes sipas nenit 610 pg 6 dhe 7 i K.Pr.Civile.

Referuar tabelës Nr. 2 me të dhëna statistikore për çështjet pa palë kundërshtare, në total 36 çështje, rezulton se 24 (njëzet e katër) prej tyre kanë qenë me objekt “kundërshtim veprimesh përmbarimore”, nga të cilat vetëm 1 (një) prej tyre është gjykuar brenda afatit 30 ditor. 23 (njëzet e tre) çështje të tjera janë gjykuar tej afateve ligjore, me një kohëzgjatje që varion nga 62 ditë deri në 71 ditë për çështjet e shqyrtuara në seancë gjyqësore, ndërkohë që afati ligjor për to është 45/ditë dhe 34 deri në 82 ditë për çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi, ndërkohë që afati ligjor për to është 30/ditë.

(iii) 5 (pesë) çështje tek tabela nr. 3 tek kategoria e çështjeve “familjare me palë kundërshtare” me objekt urdhër mbrojtje të cilat kanë përfunduar jashtë afatit ligjor prej 15 ditësh nga momenti i regjistrimit të çështjes (ankimit). Sipas nenit 21/2 i ligjit nr. 47/2018 « Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar,³⁵ këto çështje duhet të përfundojnë brenda një afati prej 15 ditësh nga momenti i regjistrimit të çështjes (ankimit).

Referuar tabelës Nr.3 me të dhëna statistikore për çështjet familjare me pale kundërshtare, gjyqtari ka gjykuar gjithsej 6/çështje me objekt “Lëshim urdhër mbrojtje/i menjëhershëm mbrojtje”. Nga këto 6/çështje, vetëm 4 prej tyre që janë regjistruar në Apel pas hyrjes në fuqi të ligjit të mësipërm, janë gjykuar tej afatit 15/ditor. Ndërkohë që çështja me numër rendor 6 dhe 8 janë regjistruar para hyrjes në fuqi të ligjit dhe për to zbatohet standardi minimal.

Sa më sipër për efekt të kësaj kategorie do të konsiderohen të shqyrtuara tej afatit vetëm 4 çështje. Koha e gjykimit të tyre varion nga 42 deri në 117 ditë, me një mesatare vonese prej 53 ditë nga afati 15/ditor i parashikuar në K.Pr.Civile.

Sa më sipër, në total nga 140 (njëqind e dyzet) çështje gjithsej të cilat kanë të parashikuar afat ligjor për përfundimin e tyre (duke zbritur çështjet e sipërcituara), rezulton që gjyqtari ka përfunduar jashtë afatit ligjor 32 (tridhjetë e dy) çështje ose 23 % të çështjeve që parashikojnë afat ligjor për përfundimin e tyre.

³⁵ Ligji është miratuar në dt.23.07.2018 dhe ka hyrë në fuqi në dt. 18.08.2018 (Fletore zyrtare Nr.118/2018 dt. 03.08.2018)

Gjyqtari dhe kryetari i gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit kanë theksuar se pavarësisht objektivit parësor për gjykimin e çështjeve brenda afateve ligjore, për vitin 2019 koncepti i afateve të gjykimit humbi kuptimin praktik, për shkak të mbingarkesës e cila vinte kryesisht për shkaqe të rishortimit të çështjeve të kolegëve të larguar apo të pezulluar, apo edhe për shkak të mungesës së stafit gjyqësor. Sipas gjyqtarit respektimi i afateve kohore për gjykimin e çështjeve ka qenë pak a shumë një hap para e dy hapa pas dhe kjo ka ndodhur jo për shkak të mungesës së angazhimit maksimal nga ana e tij, por për faktorë të njohur dhe të pavarura nga ana e tij.

KONKLUSIONE:

Nëse do të bënim vetëm një analizë matematikore të të dhënave statistikore, referuar Metodologjisë, përqindja e rezultuar (23 %) përkon me pikëzimin me 9 pikë. Por analiza e të dhënave statistikore nuk bëhet nga vlerësuesi në mënyrë matematikore, por është një analizë logjike e të dhënave burimore. Referuar ngarkesës së gjyqtarit si relator dhe anëtar (në total ka gjykuar 276 çështje si relator, 447 çështje si anëtar), mendimit të kryetarit dhe vetëvlerësimit të gjyqtarit, vlerësoj se numri i çështjeve me afat ligjor ku gjyqtari ka qenë relator ka qenë i konsiderueshëm, pothuajse 1/3 e çështjeve të shqyrtuara prej tij në vitin 2019, prandaj për shkak të ngarkesës në punë vlerësohet që të ketë rritje me një shkallë pikëzimi për këtë tregues, nga 9 me 12 pikë. Por gjyqtari nuk mund të pikëzohet maksimalisht, pasi pavarësisht ekzistencës së rrethanave objektive të pasqyruara nga ana e gjyqtarit në formularin e integruar, ai duhet t'i kishte kushtuar një rëndësi të veçantë dhe parësore çështjeve me afat ligjor, të cilat për shkak të rëndësisë së tyre duhet të gjykohen jo brenda afateve të arsyeshme, por brenda afateve të përcaktuara shprehimisht nga ligji procedural përkatës. Nga ana tjetër volumi dhe rritja e papritur e numrit të çështjeve nuk justifikon pikëzim maksimal në këtë rast, pasi gjyqtari i apelit i nxjerr çështjet për gjykim sipas kalendarit të gjykimit, pavarësisht kohës së regjistrimit të çështjeve në gjykatë. Në këtë kalendar, çështjet për të cilat parashikohen afate ligjore shqyrtimi, kanë përparësi nxjerrje për gjykim, krahasuar me çështjet e tjera.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar përqindjes së çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor dhe shkallës së përgjegjësisë së gjyqtarit, vlerësohet se në lidhje me këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet me 12 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjyqtari subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 133 (njëqind e tridhjetë e tre) çështje në cilësinë e relatorit të cilat kanë të parashikuar afat standard minimal kohor (pa përfshirë këtu çështjet për të cilat parashikohen afate gjykimi), nga të cilat:

- (i) 71 (shtatëdhjetë e një) çështje tek tabela nr. 1 e kategorisë “civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, nga të cilat konstatohen vetëm 2 (dy) çështje jashtë afatit standard minimal kohor, dhe më konkretisht çështja me nr. 3 dhe 34 të cilat kanë përfunduar

jashtë afatit 6 (gjashtë) mujor të parashikuar nga vendimi i ish KLD-së, dhe i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.

- (ii) 11 (njëmbëdhjetë) çështje tek tabela nr. 2 e kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, të cilat kanë përfunduar të gjitha brenda afatit 4 (katër) mujor të parashikuar nga vendimi i ish KLD-së dhe i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.
- (iii) 3 (tre) çështje tek tabela nr. 3 kategoria e çështjeve “*familjare me palë kundërshtare*”, të cilat kanë përfunduar të gjitha brenda afatit 6 (gjashtë) mujor të parashikuar nga vendimi i ish KLD-së dhe i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.
- (iv) 4 (katër) çështje tek tabela nr. 6 kategoria e çështjeve “*tregtare pa palë kundërshtare*”, të cilat kanë përfunduar të gjitha brenda afatit 4 (katër) mujor të parashikuar nga vendimi i ish KLD-së dhe i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.
- (v) 14 (katërmëdhjetë) çështje tek tabela nr. 7 tek kategoria e çështjeve “*marrëdhënie pune*”, të cilat kanë përfunduar të gjitha brenda afatit 6 (gjashtë) mujor të parashikuar nga vendimi i ish KLD-së dhe i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.
- (vi) 1 (një) çështje tek tabela nr. 8 kategoria e çështjeve “*krime*” e cila ka përfunduar brenda afatit 6 (gjashtë) mujor të parashikuar nga vendimi i ish KLD-së dhe i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.
- (vii) 29 (njëzet e nëntë) çështje tek tabela nr. 14 tek kategoria e çështjeve “*juridiksion fillestar*”, nga të cilat konstatohet se kanë përfunduar të gjitha brenda afatit 6 (gjashtë) mujor të parashikuar nga vendimi i ish KLD-së dhe i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.

Gjyqtari dhe kryetari i gjykatës në Formularin e Vlerësimit kanë bërë prezent një sërë shkaqesh të cilat ndikojnë në kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve të cilat lidhen me ngarkesën e lartë, fakt i cili rezulton edhe nga analiza e të dhënave statistikore. Gjithashtu bëhet prezent fakti se kohëzgjatja e gjykimeve asnjëherë nuk ka qenë për shkak të gjyqtarit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pikëzimi për këtë tregues përcaktohet duke iu referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji nuk parashikon afat ligjor gjykimi. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor (2 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, pa përfshirë çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi (133 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 1.5 % të çështjeve në tejkalim të standardit minimal kohor.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe analizës së mësipërme lidhur me afatin e gjykimit të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor në Gjykatën e Apelit, raportit të këtyre çështjeve me numrin total të çështjeve që rezulton në masën 1.5 %, pavarësisht ngarkesës në punë, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdesin maksimal për përfundimin e gjykimit të çështjeve brenda afateve të shkurtra dhe në 98.5 % të tyre duke respektuar standardin minimal kohor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se në lidhje me këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të përfunduara në tejkalim të standardit minimal kohor rezulton të jetë vetëm 1.5 %.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e integruar burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimet të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje për të gjitha kategoritë, me standardin minimal kohor në fuqi për kategori çështjes, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se ky afat për të gjitha kategoritë e çështjeve. Pavarësisht volumit të çështjeve, specifikave të gjykimit në apel në lidhje me organizimin e punës për shkak se gjykimi zhvillohet me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për zhvillimin e gjykimit brenda afateve të shkurtra, duke treguar shkallë të lartë aftësie.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se në lidhje me këtë tregues, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, prandaj aftësia e gjyqtarit pikëzohet me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se:

Gjyqtari për vitin 2019, si relator, ka përfunduar 276 çështje dhe i janë caktuar 479 çështje. Ndërkohë si anëtar gjyqtari ka përfunduar 443 çështje në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe 4 çështje i caktuar në gjykata të tjera.

Referuar raportit të çështjeve të përfunduara në cilësinë e relatorit me çështjet e caktuara brenda të njëjtit vit kalendarik, rezulton që rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore për gjyqtarin {...} është 0,57620042 ose 57.6 %.

Në Formuarin e Vlerësimit gjyqtari dhe kryetari i gjykatës kanë parashtruar se nëse do të funksiononin të gjitha hallkat që ligji parashikon si duhet të funksionojnë në gjykimin në apel, rendimenti do të mund të ishte shumë i lartë.

Pavarësisht këtij fakti që ka ndikuar në të dhënat që konsiderohen për përlogaritjen e rendimentit, rezulton se gjyqtari ka përfunduar gjatë periudhës së vlerësimit më pak çështje se standardi minimal sasior i zbatueshëm³⁶, pasi rezulton se ka përfunduar gjykimin për 276 çështje në total, nga të cilat 90 janë kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak dhe 186 janë çështje civile.

KONKLUSIONE:

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësuar në tërësinë e tyre, si dhe referuar analizës së të dhënave statistikore nga të cilat rezulton se gjyqtari ka përfunduar si relator 276 çështje, nga të cilat 186 çështje civile dhe 90 kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve është 57.6 %. Nga ana tjetër duke iu referuar edhe numrit të lartë (447 çështje) të çështjeve të përfunduara nga gjyqtari në cilësinë e anëtarit, vlerësoj se rendimenti duhet të pikëzohet një shkallë më lart se sa rezulton nga të dhënat statistikore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se në lidhje me këtë tregues, pavarësisht se rendimenti i përfundimit të çështjeve është 57.6 %, ky tregues pikëzohet me 4 pikë, pasi gjyqtari ka përfunduar një numër relativisht të lartë çështjesh në cilësinë e relatorit dhe anëtarit por, nga ana tjetër, nuk rezulton të ketë tejkaluar standardin minimal sasior në fuqi, për çështjet civile të përfunduara si relator.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin procedural të parashikuar në ligj, është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural, për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari dhe kryetari i gjykatës kanë parashtruar se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal në respektimin e afateve procedurale për arsytimin e vendimeve gjyqësore dhe në asnjë rast, nuk rezulton që vendimi të jetë arsytuar me vonesë, pavarësisht numrit të vendimeve përfundimtare të marra gjatë periudhës së vlerësimit.

KONKLUSIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për arsytimin e vendimeve në një kohë të shpejtë dhe në çdo rast,

³⁶ Sipas parashikimeve të Vendimit nr.261/2, viti 2010 të KLD-së, në pikën 3, shkronja "i", sa i përket standardit sasior për gjyqtarin e seksionit civil të Gjykatës së Apelit, parashikohet se: "Standardi sasior nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda një viti kalendarik të një ngarkese pune minimale si më poshtë: i) Gjyqtari i Gjykatës së Apelit i dhomës civile, si relator, jo më pak se 200 gjykime çështjesh civile."

brenda afatit procedural, pavarësisht volumit të çështjeve të përfunduara dhe faktorëve të tjerë që kanë ndikuar në ngarkesën e tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: *Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues pikëzohet me 15 pikë, duke qenë se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore është më shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.*

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se:

- Për çështje të kategorisë “civile të përgjithshme me palë kundërshtare” është 1.36 seanca gjyqësore;
- Për çështje të kategorisë “familjare me palë kundërshtare” është 1.2 seanca gjyqësore;
- Për çështje të kategorisë “marrëdhënie pune” është 1.3 seancë gjyqësore;
- Për çështje të kategorisë “krime” është 6 seanca gjyqësore;
- Për çështje të kategorisë “juridiksion fillestar” është 1.4 seanca gjyqësore

Në Gjykatat e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm, ka një rregullim të posaçëm ligjor për përpunimin dhe vënien në lëvizje të çështjeve gjyqësore referuar nenit 426 të Kodit të Procedurës Penale, nenit 460 pika 2 dhe 4 të Kodit të Procedurës Civile dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 78 datë 30.05.2019 “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit” në të cilin përcaktohet “*Datë nxjerrje për gjyq*” si veprim që përcakton kohën e fillimit të shqyrtimit të çështjes. Ky moment, përveç çështjeve për të cilat ligji procedural parashikon afat ligjor shqyrtimi, kushtëzohet nga kalendari i shqyrtimit të çështjeve, i cili duhet të marrë për bazë radhën, sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit për çështjet e ardhura mbi bazë apelimi dhe në rastet kur kjo gjykatë shqyrton çështje të juridiksionit fillestar, planifikimi i seancës së parë gjyqësore ndjek rregullave të përcaktuara në ligjet procedurale, duke mbajtur parasysh objektin e çështjes dhe kalendarin e shqyrtimit të çështjeve.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short, evidentohet se gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Konstatohet nga aktet në dosje burim vlerësimi se gjyqtari për çdo çështje të ketë disponuar me urdhër për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes në Apel duke caktuar seancën e parë gjyqësore dhe duke pasqyruar në këtë urdhër urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen

e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse sipas kriterëve të parashikuara në nenin 460 e vijues të K.Pr.Civile.

Nga 6 dosje burim vlerësimi, rezulton se është zhvilluar vetëm 1 (një) seancë gjyqësore për përfundimin e tyre, ndërkohë që për 2 çështjet e tjera janë zhvilluar respektivisht 2 dhe 3 seanca gjyqësore për përfundimin e tyre. Rezulton që në këto dy çështje, seancat janë shtyrë për shkaqe të pavarura nga ana e relatorit të çështjes, dhe po kështu seancat gjyqësore janë shtyrë brenda një afati në maksimum prej 20 - 30 ditësh nga njëra - tjetra. Në 2-3 raste në të cilat seancat gjyqësore nuk janë zhvilluar për shkak të mosformimit të trupit gjykues (*shkaqe objektive të anëtareve të tjerë të trupit gjykues, trajnime jashtë vendit, apo takime pune ne KLGJ*), rezulton që seancat vijuese të jenë planifikuar në një kohë relativisht të afërt dhe janë marrë masa efektive për të siguruar vijimin pa vonesa të gjyqimit. Pra në tërësi konstatohet se shtyrjet e seancave kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e relatorit të saj.

Konstatohet gjithashtu se 5 çështje burim vlerësimi kanë përfunduar brenda afatit standard minimal kohor nga momenti i nxjerrjes së çështjes në seancë gjyqësore. Ndërkohë vetëm një prej tyre (referuar të dhënave statistikore) ka përfunduar tej afatit ligjor të përcaktuar në ligj (neni 609 i K.Pr.Civile) për përfundimin e saj. Por sikundër është cituar edhe më sipër, pavarësisht faktit që referuar datës së regjistrimit të kësaj çështje dhe datës së përfundimit të saj konstatohet se çështja ka përfunduar tej afatit ligjor prej 60 ditësh të parashikuar në ligj, edhe kjo çështje do të konsiderohet si e mbaruar në afat pasi çështja mban si datë regjistrimi datën 21.01.2017. Afati ligjor 60 ditë për përfundimin e tyre është parashikuar për herë të parë me ndryshimet që i janë bërë Kodit të Procedurës Civile me ligjin nr. 114/2016, ligj ky i cili është miratuar në datë 03.11.2016 dhe ka hyrë në fuqi në datë 30.11.2016, pra 15 ditë pasi është botuar në fletoren zyrtare nr. 219 datë 15.11.2016. Në lidhje me këtë çështje, pavarësisht faktit që në kohën e regjistrimit të saj në Gjykatën e Apelit (Janar 2017), ky ligj kishte hyrë në fuqi, dhe pavarësisht rregullit të ligjit procedural në kohën e gjyqimit, afati 60 ditë për përfundimin e saj nuk duhet të llogaritet si afat për gjykimin e çështjes në Apel, por duhet të konsiderohet si çështje me afat standard minimal kohor, pasi ligji i ri nr. 114/2016 që ka sjellë këtë ndryshim, nuk ka qenë në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesë padive përkatëse pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, e për pasojë nuk duhet të jetë as ligji procedural në gjykimin në Apel. Ky interpretim bëhet edhe në frymën e legjislatorit të parashikuar në nenin 109 të ligjit 38/2017, pavarësisht faktit që vetë ligji nr. 114/2016 nuk parashikonte ndonjë dispozitë kalimtare në lidhje me zbatueshmërinë e tij.

Nuk konstatohet asnjë rast që vetë gjyqtari të jetë bërë shkak për moszhvillimin dhe shtyrjen e seancave gjyqësore. Gjithashtu gjyqtari ka qenë i kujdesshëm në pranimin apo jo të kërkesave të palëve për shtyrjen e seancave gjyqësore, referuar bazueshmërisë së tyre dhe pa cënuar procesin e rregullt ligjor. Në rastet kur palët kanë kërkuar kohë që të njihen me aktet dhe për pasojë kanë kërkuar shtyrjen e seancës, me vendim të ndërmjetëm është vendosur refuzimi i kërkesës si e pabazuar në ligj.³⁷ Nga ana tjetër, vlerësohet se gjyqtari ka treguar kujdes në planifikimin e seancave gjyqësore dhe sigurimin e administrimit efikas të seancave gjyqësore.

³⁷ Vendimi nr. 483 datë vendimi 20.05.2019 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

Referuar sa më sipër, për treguesin e “numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive”, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është në total 2.2 seanca gjyqësore dhe gjyqtari në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

KONKLUZIONE:

Referuar sa më sipër, për treguesin e “numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive”, duke iu referuar të dhënave statistikore të çështjeve me palë kundërshtare, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 2.2 seanca dhe gjyqtari në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të tyre, prandaj gjyqtari duhet të vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se në lidhje me treguesin “numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore në dosjet e analizuara është 2.2 seanca dhe në çdo rast gjyqtari ka treguar shkallë të lartë aftësie në shmangien e seancave joproduktive.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se :

Në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtari i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë, duke respektuar kalendarin e gjykimeve, sipas parashikimeve të neneve 460 pika 2 dhe 4 të Kodit të Procedurës Civile dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 78 datë 30.05.2019 “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit”, duke marrë në konsideratë edhe kërkesat e palëve për përshpejtimin e gjykimit apo natyrën e çështjeve referuar objektit të saj.

Pas vënies në lëvizje të çështjeve, gjyqtari, në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore ka caktuar seancën dhe ka urdhëruar kryerjen e njoftimeve përkatëse për palët.³⁸ Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara në procesverbalin audio të seancave (nuk rezultojnë në rastin konkret të përzgjedhura çështje të shqyrtuara në dhomë këshillimi).

Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në apel (*neni 464 i K.Pr.Civile dhe neni 249 i K.Pr.Penale*) kur është gjykuar si shkallë e dytë mbi bazë ankimi.

³⁸ Neni 460/2/5 i K.Pr.Civile

Gjatë zhvillimit të gjykimit, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë sipas nenit 461 të K.Pr.Civile, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve mbi shkaqet e ankimit, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, etj.*).

Përgjithësisht seancat kanë filluar me vonesa të cilat varrojnë (nga 2 min. – 1 orë 10 minuta). Vetëm 4 seanca kanë filluar me më shumë se 15 min vonesë. Një seancë gjyqësore që i përket kategorisë së çështjes “masë sigurimi”, pavarësisht se rezulton e filluar me 1 orë e 10 min. vonesë, ajo ka qenë produktive dhe vonesa nuk rezulton të ketë ndikuar në ecurinë e procesit. Po kështu, evidentohet se seancat gjyqësore janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio, si dhe pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur në ekstraktin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

KONKLUZIONE:

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit në apel.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: *Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 20 pikë.*

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se aktet në dosje janë renditur duke ndjekur rendin kronologjik (sipas datës së aktit). Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj. Në rastin konkret, ndjekja e rendit kronologjik për renditjen e akteve, pa i grupuar ato sipas kategorisë, duke qenë se janë zhvilluar përgjithësisht një numër i vogël seancash, nuk krijon vështirësi në aksesimin e dosjes.

Renditja e akteve në dosjet e përzgjedhura me short për vlerësimin është e rregullt dhe dokumentet janë lehtësisht të aksesueshme, duke përmbajtur aktin e zhvillimit të shortit,

vendimin për caktimin e seancës gjyqësore, njoftimet për çdo seance gjyqësore, diskutimet me shkrim të palëve, ekstraktet e procesverbalit të seancave sipas datave dhe vendimin përfundimtar të gjykatës.

KONKLUZIONI:

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është “shumë e lartë” dhe duhet të pikëzohet me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit , të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short, ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance gjyqësore, vendimet gjyqësore) si dhe aktet e paraqitura nga palët (provat e paraqitura për herë të parë në Gjykimin në Apel – tek kërkesa e caktimit të masës së sigurimit, diskutimet përfundimtare të palëve). Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
91	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, nuk evidentohet të ketë të dhëna që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit.

Sa i përket rezultateve të verifikimit të ankesave, referuar informacionit të përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën 3055/1 prot. datë 30.12.2020 dhe shkresës nr. 3057/3 prot. datë 27.01.2021, rezulton se për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019, për gjyqtarin {...} janë depozituar dy ankesa:

(i) Ankues {...} depozituar ankesa pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 6321 prot datë 19.12.2019 dhe regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1692 prot datë 14.07.2020. Me vendimin nr. 1692/3 prot datë 26.01.2021 është vendosur “Arkivimin e ankesës së ankuesit {...}”.

(ii) Ankues {...}, depozituar ankesa pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 6513/1 Prot datë 30.12.2019 dhe regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1565 prot datë 08.07.2020. Me vendimin nr. 1565/3 prot datë 26.01.2021 është vendosur “Arkivimi i ankesës së ankueses {...}”.

Referuar të dy vendimeve të sipërcituara rezulton se shkaqet dhe pretendimet e ngritura në dy ankesat kanë lidhje me pretendime për shkelje procedurale gjatë shqyrtimit të çështjes, çështje të cilat bazuar në K.Pr.Civile duhet të zgjidhen nga gjykatat me të larta mbi bazë apelimi gjyqësor dhe në këtë kontekst asnjë prej ankesave nuk ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë.

Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezulton se për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019 për gjyqtarin {...} nuk është dhënë dhe as është zbatuar ndonjë e tillë.

Gjyqtari dhe Kryetari i gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtarit në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit, shfaqje të sjelljeve që tregojnë mungesë respekti, vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje, apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, gjatë ushtrimit të detyrës.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: *Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e etikës së gjyqtarit në treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.*

3.B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, rezulton të jenë regjistruar pranë ILD-së dy ankesa me të dhënat si më sipër në pikën 3.A.a.

Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezulton se për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019 për gjyqtarin {...} nuk është dhënë apo zbatuar ndonjë e tillë.

Nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe të analizuar në vendimet e ILD, nuk rezultojnë të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmëritë e publikut.

Nga raporti i ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 290/23 prot. datë 29.09.2020, konkludohet se: *deklarimi i pasurisë është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicje që të dëshmojnë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo sjelle tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit, vlerësohet se gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e integritetit të gjyqtarit në treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “shumë e lartë” dhe duhet të pikëzohet me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit, apo përmbajtjes së formularit të integruar të vlerësimit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit në treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se për periudhën 01 janar 2019 – 31 Dhjetor 2019, janë paraqitur 7 (shtatë) kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit nga të cilat janë rrëzuar 5 (pesë) dhe janë pranuar vetëm 2 (dy) prej tyre. Nga ana tjetër, rezulton që nga ana e gjyqtarit nuk është paraqitur asnjë kërkesë për heqje dorë nga gjykimi.

KONKLUZIONI

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, referuar dhënave burimore për ekzistencën e

numrit të kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit (*vetëm dy kërkesa janë pranuar, por jo për shkak të konfliktit të interesit*), vlerësohet se numri i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është i pakonsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: *Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se për në treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “i pakonsiderueshëm”.*

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik rezulton se gjyqtari gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, i kuptueshëm. Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

Të njëjtat cilësi evidentohen edhe në vetëvlerësimin e gjyqtarit dhe vlerësimin e kryetarit lidhur me këtë tregues.

KONKLuzioni

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit.

Gjyqtari dhe kryetari e gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të tij me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale, përfshirjen në diskutime ligjore, organizimin e punës në gjykatë dhe komunikimin brenda trupave gjyqësore.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore ndërkohë që gjyqtari dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë duke parashtruar se gjyqtari ka komunikim korrekt me stafin e gjykatës.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ekspertit dhe pjesëmarrësit.

Konkretisht evidentohet se gjyqtari {...} përgjatë vitit kalendarik 2019, ka marrë pjesë në 5 (pesë) aktivitete trajnues pranë Shkollës së Magjistraturës, në rolin e ekspertit/pjesëmarrësit,

konvertuar në numër ditësh 12 ditë³⁹. Kohëzgjatje kjo që është brenda kufijve të parashikuar nga 5 deri në 40 ditë në vit, në periudhën një vjeçare të vlerësimit.

Gjithashtu referuar dokumentacionit të paraqitur nga vetë gjyqtari, rezulton se ka marrë pjesë në aktivitete jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në Prill 2019 ka marrë pjesë në një aktivitet të organizuar nga Këshilli i Europës në Sarajevë, BiH, me objekt nenin 10 të KEDNj, dhe në 02-13 Shtator 2019 në një program shkëmbimi profesional me gjyqtarë të tjerë europianë, organizuar nga Rrjeti European i Trajnimit Gjyqësor me mbështetjen e Bashkimit European, në Hamburg, Gjermani.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, pikëzohet me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtari {...} përgjatë vitit kalendarik 2019, ka marrë pjesë në 1 (një) aktivitet trajnues pranë Shkollës së Magjistraturës, në rolin e ekspertit, në fushën procedurale civile, në trajnimin datë 10 - 11 Dhjetor me temë “*Aspekte të procedurës civile me ndikim në rritjen e efektivitetit të gjykimit civil*”, trajnim në të cilin ka qenë në cilësinë e ekspertit dhe rezulton që të ketë qenë prezent gjatë të dyja ditëve në të dyja sesionet e çdo dite.

Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, nuk rezultojnë të dhëna.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtarin {...} duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij në cilësinë e ekspertit në disa aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

³⁹ Rregullorja e Brendshme e Shkollës së Magjistraturës në pikën 9 të nenin 55 të saj, parashikon : “Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë: 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrjeje në trajnim; 1 ditë pjesëmarrjeje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrjeje në trajnim; 1 ditë pjesëmarrjeje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrjeje në trajnim.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, pikëzohet me 5 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjyqtari në formularin e integruar të ketë deklaruar se gjatë vitit 2019, me pëlqimin e drejtuesit të gjykatës, ka mbajtur kontakt me delegacione të huaja që vizitonin gjykatën, duke shkëmbyer mendime me ta, për çështje me rëndësi për gjyqësorin. Po ashtu, ka dhënë mendimin dhe sugjerimet e tij në lidhje me vendimin e KLGJ nr.78, datë: 30.05.2019 “Për Kalendarin e Shqyrtimit të Çështjeve në Gjykatën e Apelit”, për shkak edhe se ka marrë pjesë drejtpërdrejtë në draftimin e nenit 460 të Kodit të Procedurës Civile, siç u ndryshua nga ligji nr.38/2017. ..

Nga veprimtaritë e përmendura nga gjyqtari, për efekt të këtij treguesi ka rëndësi vetëm kontributi i gjyqtarit nëpërmjet dhënies së mendimit të tij për draftimin e më pas miratimit nga ana e KLGJ të aktit nënligjor “Për Kalendarin e Shqyrtimit të Çështjeve në Gjykatën e Apelit”. Pavarësisht se angazhimi i gjyqtarëve në punët e Këshillit është mbi baza vullnetare dhe pa pagesë, kontributi i tyre në hartimin e akteve nënligjore me qëllimin primar përmirësimin e punës në gjykatë, duhet të vlerësohet. Sikundër bashkëpunimi me Këshillin për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit, apo për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues, edhe bashkëpunimi dhe kontributi real i dokumentuar në nxjerrjen nga ana e KLGJ të akteve nënligjore në shërbim të punës së përditshme në gjykatë, konsiderohet veprimtari ndërinstitucionale që kërkon kohë dhe angazhim nga ana e gjyqtarit.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtarin {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues pikëzohet me 5 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, rezulton që gjyqtari të

ketë dorëzuar së bashku me formularin e integruar botimin II të tekstit mësimor të përditësuar “Procedurë Civile” (Pjesa I), ku ai është bashkautor. Sipas gjyqtarit, ky tekst mësimor ka inkorporuar ndryshimet më të fundit ligjore në Kodin e Procedurës Civile dhe është pritur me vlerësime mjaft të larta nga punonjësit e sektorëve të ndryshëm të drejtësisë.

Referuar botimit të paraqitur nga ana e gjyqtarit rezultojnë që botimi “Procedurë Civile” pjesa e II Botimi II me bashkautorë {...}dhe {...}, është një botim i miratuar me vendimin e datës 22.01.2018 të Departamentit të së Drejtës Civile, Fakulteti i Drejtësisë Universiteti i Tiranë, ISBN 978-9928-258-06-9, shtëpia botuese Albas 2018.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit vlerësoj se, për gjyqtarin {...}, ky tregues pikëzohet me 0 pikë, sepse punimi shkencor duke qenë botim i vitit 2018, nuk përbën punë krijuese shkencore brenda periudhës së vlerësimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë që gjyqtari nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, vlerësohet dhe pikëzohet me 0 pikë.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, për treguesin “publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë angazhim i gjyqtarit dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
95	Shkëlqyeshëm

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	91	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave	100	Shkëlqyeshëm

profesionale		
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	95	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	386	Shkëlqyeshëm

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuarra dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtari {...} të mbajë në konsideratë angazhimin e tij të vazhdueshëm në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit të saj për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

